

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POSTA E KOSOVËS SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **vetak-25-2619-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **“Konsulencë ligjore për nevoja të Postës së Kosovës Sh.A.”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

CENTER FOR LEGAL SERVICES L.L.C.

Rr. “Ali Vitia” Ob. 4 H.3 B.7

Prishtinë

10000

049 11 33 58

(Numri i Faks-it)

Adrianit Ibrahim

info@cls-rks.com



16.06.2025

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 07.04.2025
Njoftimi B58 mbi vendimin – 05.06.2025
Kërkesa për rishqyrtim – 09.06.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 10.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim – 09.06.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 10.06.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

SQARIM HYRËS

Me datë 09.06.2025 ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK me ç'rast kemi prezantuar 6 pretendime ankimore të mbështetura në fakte dhe argumente konkrete, të ligjshme dhe të matshme. Sidoqoftë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim duke mos prezantuar asnjë kundër-argument bindës dhe të ligjshëm. Prandaj ne jemi detyruar që të parashtrojmë këtë ankesë pranë Panelit Shqyrtues në OSHP.

Mund të thuhet që refuzimi i pretendimeve nga ZPP është bërë në mënyrë arbitrare pa shqyrtuar fare argumentet tona dhe pa administruar asnjë provë apo dëshmi të cilën ne e kemi prezantuar. Për të demonstruar arbitraritetin e vendimmarrjes nga ZPP, mund të marrim si shembull pretendimin ankimor nr. 1 i cili i referohet arsyes së prezantuar nga AK për eliminimin tonë kinse në pozicionin nr. 1 të tabelës nr. 1 të paramanës ne kemi ofertuar nën 50% të tarifave të përcaktuara në rregulloren e odës së avokatëve (OAK). Pozicioni nr. 5 është emërtuar si vijon “Çështjet juridiko-administrative pranë institucioneve shtetërore ose juridike”. Pretendimi ynë ankimor ka qenë se ky pozicion me këtë emërtim identik nuk përcaktohet askund në rregulloren për tarifën e OAK. Ndërsa në përgjigjen e AK lidhur me këtë pretendim përmendet pika h) e numrit tarifar 6 të rregullores ku thuhet “Për çështje juridiko administrative pranë institucioneve shtetërore ose personave juridik, kur ajo çështje nuk ka vlerë të caktuar monetare, shpërblimi llogaritet me bazën tarifore prej 160,00 euro”. As për nga formulimi dhe as për nga qëllimi kjo dispozitë nuk përputhet me pozicionin nr. 5 të paramasës për të cilin ne jemi eliminuar. Fillimisht këtu përcaktohen rastet e përpilimit të parashtrësive me të cilat iniciohet një procedurë administrative pa vlerë monetare të përcaktuar. Ndërsa te situacioni 1 i paramasës janë përcaktuar të gjitha vlerat e mundshme të parashtrësive (p.sh pozicioni 1 vlerat nga 0 deri në 5,000, pozicioni 2 vlerat nga 5,000 deri në 10,000, pozicioni 3 vlerat nga 10,000 deri në 100,000 si dhe pozicioni 4 vlerat mbi 100,000). Tutje pika h) përcakton vetëm bazën dhe jo totalin që përfshin edhe paushallin etj ndërsa në paramasë është kërkuar të ofertohej totali i çmimit. Sidoqoftë, nëse AK e ka pasur qëllimin që të evidentoj këtë pikë të rregullores në paramasë është dashur që t'a formuloj saktësisht siç e ka menduar dhe jo të vendoset një formulim krejt ndryshe në paramasë dhe tash AK të tentoj të fshihet pranë një dispozite krejt tjetër që nuk ndërlidhet me pozicionin 5.

Dispozita e cituar më sipër në të cilën thirret AK, nuk ka qenë pjesë e paramasës dhe as kërkesë e dosjes së tenderit. Rrjedhimisht AK nuk mund të eliminoj ofertën tonë mbi bazën e një kërkesë që nuk ka qenë pjesë e DT/paramasës. Një veprim i tillë është i ndaluar sipas nenit 40.12 të RRPP ku thuhet se “Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit”. Në rastin konkret pozicioni 5 përmban një formulim krejt tjetër (gjuhësor, logjik dhe ligjor) nga pika h) e tarifës së OAK të cilën e ka përmendur AK në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim. Me fjalë të tjera pika h) nuk është specifikuar as në paramasë dhe as në DT prandaj AK nuk mund të eliminoj ofertën tonë mbi bazën e kësaj pike.

Vlen të shtohet se edhe vet AK është kundërthënëse në arsyet e saj eliminuese. Kjo për arsye se pika h) përcakton që baza e shpërblimit është 160 euro ndërsa në letrën standarde për eliminimin tonë AK thotë se pozicioni 5 i paramasës shpërblehet me 60 euro. E vërteta është që ky pozicion me formulimin e tillë identik nuk përcaktohet fare me tarifë të OAK dhe çmimi me të cilin ne kemi ofertuar është jo vetëm i saktë por edhe i mjaftueshëm. Qëllimi i AK është vetëm që të shpërblej me kontratë një OE tjetër i cili është jo vetëm më i shtrenjtë

me çmim por nuk ka përmbushur as kërkesat themelore të DT.

Përgjigjet e AK në pretendimet tona të tjera nuk do t'i komentojmë fare pasi që ato manifestojnë një qasje absolute dhe arbitrare. Një qasje e tillë nuk është thjeshtë skandale por edhe inkriminuese pasi që AK me çdo kusht po tenton që të shpërblej me kontratë një OE më të shtrenjtë i cili është i papërgjegjshëm (pra duke përdorur detyrën dhe autoritetin zyrtar, po favorizojnë hapurazi një OE dhe po dëmtojnë të drejtat tona si OE ankues në njërin anë por edhe buxhetin dhe interesat e AK në anën tjetër). Sidoqoftë, ne konsiderojmë se të gjitha pretendimet tona ankimore janë të bazuara në tërësi prandaj të njëjtat po i përsërisim sërish me përmbajtjen identike sikurse në kërkesën për rishqyrtim. Nuk kemi asnjë dilemë që Paneli Shqyrtues pasi që të shqyrtoj faktet e prezantuara, do të ndaj bindjen e njëjtë me ne.

PRETENDIMET ANKIMORE

Autoriteti Kontraktues (tutje “AK”) me datë 05.06.2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë OE “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.” (tutje si “tenderuesi i rekomanduar”). Së bashku me këtë vendim është bashkangjitur letra standarde përmes të cilës ne si OE jemi eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Në vijim të kësaj kërkesë për rishqyrtim do të prezantojmë pretendimet tona ankimore të mbështetura në fakte dhe argumente konkrete të matshme dhe të ligjshme përmes të cilat do të konfirmohet në mënyrë të pakontestueshme që tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për arsye se nuk ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të kërkesave të dosjes së tenderit (tutje “DT”). Në anën tjetër të gjitha arsyetja eliminuese e prezantuar nga AK për eliminimin tonë është arsye e pasaktë pasi që ne kemi përmbushur të gjitha kërkesat e DT dhe jemi oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit ashtu që kemi plotësuar kriterin e dhënies së kontratës.

Në vijim po prezantojmë argumentet sipas të cilave mund të konfirmohet se arsyetja për eliminimin e ofertës tonë është arsye e pasaktë dhe e pavërtetë.

Pretendimi ankimor nr. 1 – “Nuk qëndron arsyetja eliminuese e prezantuar nga AK për eliminimin e ofertës tonë si të papërgjegjshme”.

Në letrën standarde për eliminimin e ofertës tonë arsyetja eliminuese është formuluar si vijon: “OE:Center for Legal Services L.L.C. -ka ofertuar te tabela 1 pozicioni nr.5 (pesë) me çmim 12.5€ ndersa perpilimi i parashtrësive me rregulloren e Odes së Avokateve është paraparë çmimi ma i lirë 60€ ndersa me NJK dhe DT është paraparë se Çmimet e ofertuar mos të tejkalojn çmimoren e Rregullores se tarifave te avokateve, e cila është ne fuqi ne momentin e publikimit te këtij njoftimi dhe mos te jete nen 50% te vlerës te përcaktuar ne Rregulloren e tarifave te avokateve konform nenit 4 paragrafi 3 te kësaj rregulloreje”.

Tabela numër 1 në paramasë titullohet “**përpilimi i parashtrësive në procedurë civile dhe procedura tjera**”. Kjo kategori i referohet Tarifës së Odës së Avokatëve (TOA) – Ekstrakti Tabelar konkretisht tabela me numrin tarifar 6. Shih në vijim fig. nr. 1 – kategorinë nr. 1 në paramasë si dhe fig. nr. 2 – ekstraktin tabelar të TOA nr. tarifar 6.

Fig. nr. 1 – Kategoria nr. 1 në paramasë

Konsulencë ligjore per nevoja te Postës së Kosovës Sh.A me nr prokurimi: vetak-25-2619-2-2-1 dhe numer te brendshem:PK-25-22-221					
Përpilimi i parashtrësive në procedurë civile dhe procedura tjera Rëndësia (Niveli)- I -Vlera 39 % (7,800 €)					
Nr.	Pershkrimi:	Njësia	Sasia	(çmimi x39%)	
				Çmimi per njesi me TVSH	Çmimi i peshuar
1	Kontestet e vlerës së vogël	Copë	1	39.00	15.21
2	Kontestet me vlerë mbi kontestet e vlerës së vogël deri në 10.000 euro	Copë	1	52	20.28
3	Kontestet me vlerë prej 10.000 euro e më lartë	Copë	1	104	40.56
4	Kontestet me vlerë prej 100.000 euro e më lartë	Copë	1	162.5	63.38
5	Çështjet juridiko-administrative pranë institucioneve shtetërore ose juridike	Copë	1	12.5	4.88
Çmimi total (pa peshuar ne baze te nivelit)				370.00	
Çmimi total i peshuar- kontrata me çmim më të ulët					144.30

Fig. nr. 2 – Ekstrakti tabelar në TOA – numri tarifor 6

Nr. tarifor 6. – Përpilimi i parashtresave në procedurën civile dhe procedurat tjera:

Lloji i parashtr.	Vlera e çështjes	mbi një palë	Baza	Paushal li 30 %	Gjithsejtë
Padi apo kërkesa tjera	Kontest i vlerës së vogël		60 €	18 €	78 €
	Për paditësin/të paditurin e dytë:	+ 50 %	90 €	27 €	117 €
	Për paditësin/të paditurin e tretë:	+ 50 %	120 €	36 €	156 €
	Për paditësin/ të paditurin e katër:	+ 50 %	150 €	45 €	195 €
	Për paditësin/ të paditurin e pestë:	+50 %	180 €	54 €	234 €
	Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri ne 10.000 €		80 €	24 €	104 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	120 €	36,00 €	156 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+ 50 %	160 €	48,00 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	200 €	60,00 €	260 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	240 €	72,00 €	312 €
	Kontesti me vlerë prej 10.000 € e më lartë		160 €	48 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	320 €	90 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	400 €	120 €	520 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	480 €	144 €	624 €
	Kontesti me vlerë prej 100.000 € e më lartë		250 €	75 €	325 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+25 %	312,5 €	93.75 €	406,25 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+25 %	375 €	112,5 €	487.5 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+25 %	437,5€	131,25 €	568,75 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 25 %	500 €	150 €	650 €

Në arsyen eliminuese thuhet që pozicioni nr. 5 në kategorinë nr. 1 të paramasës sipas TOA paguhet 60 euro ndërsa ne kemi ofertuar me 12.5 euro që është më pak se 50% sipas AK. Një konstatim i tillë është totalisht i pasaktë pasi që pozicioni nr. 5 është emërtuar si vijon: “Çështjet juridiko-administrative pranë institucioneve shtetërore ose juridike”. Mirëpo ky pozicion nuk ekziston fare në Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve. Ky pozicion është vendosur në mënyrë të njëanshme nga vet AK dhe evidentohet fare në asnjërin grup tarifor të ekstraktit tabelar në TOA. Pra emërtimi identik sikurse ai në poz. 5 të kategorisë 1 të paramasës nuk ekziston askund të TOA. Ky fakt jo vetëm që është i vërtetë por edhe lehtësisht i konfirmueshëm. Si shembull mund të prezantojmë fig. 3 të vijim ku përmes mekanizmit “find” të TOA (CTR+F) mund të konfirmohet brenda pak sekondave që në TOA nuk ekziston asnjë pozicion apo fjali e formuluar në mënyrë identike sikurse poz. 5 të kategorisë 1 të paramasës.

Fig. 3 – Dëshmi se në TOA nuk ekziston pozicioni 5 kategoria 1 e paramasës

krimet e rënda – neni 22 i KPPK.	200 €	60 €	260 €
----------------------------------	-------	------	-------

Nr. tarifor 6. – Përpilimi i parashtrësve në procedurën civile dhe procedurat tjera:

Lloji i parashtr.	Vlera e çështjes	mbi një palë	Baza	Pauschal li 30 %	Gjithsejtë
Padi apo kërkesa tjera	Kontest i vlerës së vogël		60 €	18 €	78 €
	Për paditësin/të paditurin e dytë:	+ 50 %	90 €	27 €	117 €
	Për paditësin/të paditurin e tretë:	+ 50 %	120 €	36 €	156 €
	Për paditësin/ të paditurin e katër:	+ 50 %	150 €	45 €	195 €
	Për paditësin/ të paditurin e pestë:	+50 %	180 €	54 €	234 €
	Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €		80 €	24 €	104 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	120 €	36,00 €	156 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+ 50 %	160 €	48,00 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	200 €	60,00 €	260 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	240 €	72,00 €	312 €
	Kontesti me vlerë prej 10.000 € e më lartë		160 €	48 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+ 50 %	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+50 %	320 €	90 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+ 50 %	400 €	120 €	520 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+50 %	480 €	144 €	624 €
	Kontesti me vlerë prej 100.000 € e më lartë		250 €	75 €	325 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	+25 %	312,5 €	93,75 €	406,25 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	+25 %	375 €	112,5 €	487,5 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	+25 %	437,5 €	131,25 €	568,75 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	+ 25 %	500 €	150 €	650 €

Përderisa në TOA nuk ekziston asnjë pozicion me emërtimin identik “Çështjet juridiko-administrative pranë institucioneve shtetërore ose juridike”, AK nuk mund të eliminojë ofertën tonë me pseudo-arsyetimin kinse kemi ofertuar nën 50% të çmimit të përcaktuar me TOA, sepse ky pozicion nuk ekziston fare në TOA por është vendosur në mënyrë të njëanshme nga vet AK. Pra nuk qëndron aspak arsyeja eliminuese e prezantuar nga AK sepse të gjitha pozicionet e paramasës që janë të përcaktuara edhe me paramasë nuk janë as më të vogla se 50% të tarifave të TOA dhe as më të larta sesa këto tarifa.

Vlen të theksohet fakti që oferta e tenderuesit të rekomanduar është 27.5% më i shtrenjtë sesa oferta jonë. Pra përtej eliminimit tonë të kundërligjshëm dhe të pabazuar, AK përmes dhënies së kontratës të një tenderuesi i papërgjegjshëm me çmim më të shtrenjtë është duke dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme edhe buxhetin publik të AK.

Sa i përket tenderuesit të rekomanduar, në vijim do të prezantojmë pretendimet ankimore të mbështetura në prova dhe argumente konkrete, ligjore, të matshme dhe të lejueshme sipas të cilave në mënyrë të pakontestueshme mund të konfirmohet se tenderuesi i rekomanduar për kontratë jo vetëm që ka ofertuar me çmim 27.5% më të shtrenjtë, por ka dorëzuar edhe ofertë absolutisht të papërgjegjshme sepse nuk janë përmbushur shumë nga kërkesat e DT.

Pretendimi nr. 2 – “Tenderuesi i rekomanduar nuk ka plotësuar si duhet formularin e tenderit lidhur me çmimin me TVSH dhe çmimin PA TVSH”.

Tenderuesi i rekomanduar nuk ka plotësuar si duhet formularin e tenderit përkatësisht nuk e ka precizuar çmimin e ofertës së tij. Ky fakt konfirmohet përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të dt. 05.05.2025 ku tenderuesi i rekomanduar në rubrikën për çmimin total me TVSH ka ofertuar me 471.82 euro. Mirëpo edhe në rubrikën e çmimit të ofertës pa TVSH sërish ka ofertuar me çmimin e njëjtë prej 471.82 euro. Shih figurën vijuese:

Fig. 4 – Procesverbali i hapjes së ofertave

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke: Numri i brendshëm Internal No Interni broj	vetak-25-2619-2-2-1 PK-25-22-221	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Konsulencë ligjore për nevoja të Postës së Kosovës Sh.A			
Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Priljubljenih Tendera		
05.05.2025	05.05.2025, 14:00:00	05.05.2025, 14:00:00	Ndërtesa Qendrore e Postës së Kosovës sh.a , Prishtinë- Rr. 28 Nëntori nr 4. Zyra e Prokurimit	2		

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndëryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dopuna/Izmjena
1.	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K., rr.Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7, 10000, Prishtina	Sherbime juridike Posta e Kosoves	Konsulencë ligjore për nevoja të Postës së Kosovës Sh.A	PO	471.82	471.82	JO
2.	Center for Legal Services L.L.C., Rr. "Ali Viti", Ob.4, H.3, B.7, 10000, Prishtinë	POSTA-2619	Konsulencë ligjore për nevoja të Postës së Kosovës Sh.A	PO	289.95	342.14	JO

Në këtë mënyrë tenderuesi i rekomanduar ka dështuar që të përcaktoj çmimin e ofertës së tij (pra mungon çmimi) por njëkohësisht nuk është plotësuar si duhet as formulari elektronik i tenderit përmes platformës eprokurimi. Që të dy këto gabime të tenderuesit të rekomanduar përbëjnë KUSHTE ADMINISTRATIVE të përcaktuara sipas pikës 10 të UPP ku thuhet se në rastet kur nuk precizohet apo mungon çmimi, tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacione shtesë. Njësoj veprohet edhe kur nuk plotësohet si duhet formulari i tenderit.

Fig. 5 – Udhëzuesi i Prokurimit Publik

Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK		
Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Nga sa u tha më sipër, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 3 – “Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmime më të ulëta sesa 50% e tarifave të përcaktuara me TOA”.

Në DT është përcaktuar kërkesa si në vijim: “Çmimet e ofertuar mos të tejkalojn çmimoren e Rregullores së tarifave të avokateve, e cila është në fuqi në momentin e publikimit të këtij njoftimi dhe mos të jete nën 50% të vlerës të përcaktuar në Rregulloren e tarifave të avokateve konform nenit 4 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje”. Tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të DT pasi që në disa pozicione të paramasës ka ofertuar nën 50% të tarifës së TOA. Më konkretisht, në pozicionin nr. 4 të kategorisë 1 të paramasës, tarifa sipas TOA është përcaktuar 325 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 153.4 euro (që është 47.2% dmth nën 50% të tarifës së TOA). Ngjashëm edhe në pozicionin nr. 4 të kategorisë 2, tarifa sipas TOA është 422.5 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 171.1 euro (që është 40.5% dmth nën 50% të tarifës së TOA). Tutje edhe në pozicionin 1 të kategorisë 5, tarifa sipas TOA është 202.8 euro ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me 100.3 euro (që është 49.45% dmth nën 50% të tarifës së TOA). Në figurën vijuese mund të shihet krahasimi në mes të pozicioneve të paramasës që ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar dhe tarifave përkatëse të TOA.

Fig. 6 – Dëshmi se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar nën 50% të tarifave të TOA

ÇMIMET NË PARAMASË	TARIFAT E TOA
--------------------	---------------

Titulli: “Konsulencë ligjore për nevoja te Postes se Kosovës Sh.A”

Nr. i prokurimit: vetak-25-2619-2-2-1

DESHMITË E SHËRBIMEVE TE KRYERA JURIDIKE

Të nderuar,

Sipas kërkesave te Dosjes se Tenderit dhe Fletës se të Dhënave te Tenderit me poshtë janë disa nga dëshmitë e shërbimeve dhe përfaqësimeve te kryera juridike, për disa nga kontraktorët.

Nr. Rendor	Përshkrim i Kontratës/Shërbimit	Data e nënshkrimit	Data e përfundimit	Klienti/ Kontraktori	Kontakti	Ofruesi i shërbimeve
1	Retainer contract for legal counsel, services and representation	13.07.2020	- vazhdon	“Mast-Jägermeister” SE Gjermani	Christopher Ratsch	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
2	Kontratë urdhri – dekreti për këshilla, shërbime dhe ndihmë juridike	01.06.2021	- vazhdon	“KIKXXL & EVROTARGET” L.L.C	Hamdi Malushaj	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
3	Kontratë urdhri – dekreti për këshilla, shërbime dhe ndihmë juridike	04.04.2022	- vazhdon	“Infosoft Systems” SH.P.K	Ajri Shej	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
4	Kontratë urdhri – dekreti për këshilla, shërbime dhe ndihmë juridike	01.08.2022	- vazhdon	“VM3” SH.P.K	Driton Abdullahi	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
5	Konsulencë ligjore për nevoja te Postes se Kosovës SH.A	05.07.2023	- vazhdon	“Posta e Kosovës” SH.A	Hasim Krasniqi – Drejtor i drejtorisë se prokurimit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.
6	Përfaqësime juridike dhe konsulencë juridike	22.08.2024	- vazhdon	“Telekomi i Kosovës” SH.A	Fatmir Gjonbalaj – Zyrtar kryesor i prokurimit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K

Sqarim: Për kontratat e mësipërme te shërbimeve juridike pagesat bëhen ne baza mujore dhe ne pajtim te nenit 69 paragrafi 4.2, pika (ii) te LPP-se kemi bashkangjitur kontratat si prova nga blerësit privat.

Vet tenderuesi i rekomanduar në listën e kontratave të prezantuara e konfirmon (pra nuk e konteston) që kontratat në fjalë janë kontrata të papërfunduara (vazhdojnë të jenë aktive). Në anën tjetër kërkesa e DT në mënyrë specifike përcakton që kontratat e prezantuara duhet të jenë të përfunduara (pra të realizuara në tërësi dhe jo kontrata aktive).

Vlen të theksohet fakti që edhe KRPP në interpretimin nr. 10 të dt. 22.11.2022 përcakton shprehimisht që kur AK kërkon nga OE që të prezantohen kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë këto kontrata duhet të jenë të përfunduara. Shih fig. vijuese:

Fig. 8 – Interpretimi i KRPP nr. 10 i dt. 22.11.2022

10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë “Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë”, gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmitë të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Afësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkruar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nënparagrafi 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkruara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për në shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hujzuara në këtë nën-paragraf. Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shumata totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet. Shembull: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të realizuara në periudhën e shkruar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkruar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Në rast se kërkesa e kontratave të realizuara në periudhën e shkruar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë i referohet së bashku një total prej 3.000.000 euro në tri vitet e fundit dhe operatori ekonomik ka realizuar (përfunduar) një kontratë tri vjeçare t në vlerë prej 3.000.000 euro (kontrata e cila ka filluar dy vite më herët), konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale vetëm me atë kontratë. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshminë Listën e kontratave të realizuara së bashku në total prej 3.000.000 euro në tri vite dhe nuk ka rëndësi se kontrata ka filluar dy vite më herët.

Vlen të shtohet po ashtu se tenderuesi i rekomanduar nuk ka prezantuar asnjë referencë dhe aq më pak dëshmitë e transfereve bankare për kontratat e prezantuara me OE privat. Sidoqoftë tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 5 - “Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar gabimisht deklaratën nën betim”.

Kërkesa e DT lidhur me përshtatshmërinë e OE është formuluar si në vijim: “Deklarata nën

betim, e cila gjindet në dosje të tenderit ANEKSI 2 të jetë e vulosur dhe e nënshkruar”. Ndërsa formulari i deklaratës nën betim sipas Aneksit 2 të DT është përcaktuar si në vijim:

Fig. 9 – Forma e deklaratës nën betim sipas aneksit 2 të DT

Konsulentë ligjore për nevojat e Postës së Kosovës Sh.A. me nr prokurimit: vetak-25-2619-2-2-1 dhe numër të brendshëm: PK-25-22-221

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Në anën tjetër tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar një parashtresë me titullin “Deklaratë nën Betim” mirëpo as për nga forma dhe as për nga përmbajtja nuk është identike me formën e prezantuar në aneksin 2 të DT. Konkretisht parashtresa e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar është si vijon:

Fig. 10 – Deklarata nën betim e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar



Titulli: “Konsulentë ligjore për nevojat e Postës së Kosovës Sh.A”
Nr. i prokurimit: vetak-25-2619-2-2-1

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K Deklaroj nën Betim se jam i përshtatshëm në përputhje me nenin 65 të Ligjit nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 1, 2, 3 4, 4.9, 5 dhe 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
Adresa e plotë:	rr.Garibaldi, hyrja 3, kati 2, nr.7/1, Prishtinë
I përfaqësuar nga:	
Emri	Agron SELIMAJ
Pozita	Drejtor menaxhues-Avokat
Nënshkrimi	
Data	29.04.2025
Vula	

Në kërkesën e DT të cituar më sipër, thuhet shprehimisht që OE duhet të dorëzojë deklaratën nën betim sipas aneksit 2 të DT respektivisht sipas formularit që është pjesë e DT. Këtë kërkesë tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur për faktin që është ndërhyrë jo vetëm në formën e deklaratës por edhe në përmbajtjen e saj. Si shembull nëse marrim paragrafin 2 të deklaratës sipas aneksit 2 të DT, kjo pjesë është formuluar si vijon:

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Ndërsa në parashtresën e tenderuesit të rekomanduar ky paragraf është formuluar si vijon:

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 1, 2, 3 4, 4.9, 5 dhe 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Ngjashëm edhe në paragrafin 1 të deklaratës është ndërhyrë duke cituar ndryshe bazën ligjore prej formularit në aneksin 2 të DT. Tutje është ndërhyrë edhe te pjesa e titullit dhe numrit të aktivitetit të prokurimit, është fshirë tërësisht emërtimit “Aneksi 2”, etj. Vlen të theksohet

fakti që ndryshimet nuk janë vetëm në formë (të cilat si të tilla nuk do të kishin ndonjë efekt material) por janë ndryshime edhe tekstuale përmbajtësore të cilat thellësisht e bëjnë dallimin në mes të formularit sipas aneksit 2 të DT dhe parashtresës së prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar. Pra në mënyrë të pakontestueshme mund të konfirmohet që tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim duke përdorur aneksin 2 të DT sikurse është kërkuar konkretisht në DT. Në anën tjetër nuk ka nevojë të thuhet që deklarata nën betim është kusht administrativ për të cilin nuk mund të kërkohej fare sqarime shtesë dhe drejtpërdrejtë duhet të eliminohet si i papërgjegjshëm ofertuesi përkatës.

Nga sa u tha më sipër, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Pretendimi nr. 6 – “*Deklarata e dorëzuar për çmimet nga tenderuesi i rekomanduar nuk është në përputhje me kërkesat e DT*”.

Ndër të tjera në DT është prezantuar edhe kërkesa si vijon “*Deklarate e dhëne nga OE se çmimet e vendosura ne paramase nuk i tejkalojnë tarifat e caktuara si dhe mos te jene nen 50% te vleres te percaktuar ne Rregulloren se tarifave te avokateve konform nenit 4 paragrafi 3 te kesaj rregulloreje*”.

Tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar një deklaratë ku nuk thuhet që “*çmimet e vendosura ne paramase nuk i tejkalojnë tarifat e caktuara si dhe mos te jene nen 50% te vleres te percaktuar ne Rregulloren se tarifave te avokateve*”. Më konkretisht, deklarata e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar duket si vijon:

Fig. 11 – Deklarata për çmimet e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar

Titulli: “Konsulencë ligjore për nevoja të Postes së Kosovës Sh.A”
Nr. i prokurimit: vetak-25-2619-2-2-1

Unë, Avokat Agron SELIMAJ ne cilësinë e pronarit dhe përfaqësuesit të autorizuar të operatorit ekonomik “SELIMAJ Legal Consulting” SH.P.K, jap këtë:

DEKLARATË

Çmimet e vendosura tek “përshkrimi i çmimeve” që i është bashkangjitur aplikimit tonë janë në përputhje me Rregulloren për tarifat e avokatëve të OAK.

Ne Prishtinë, më 29.04.2025.

SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K
Avokat Agron SELIMAJ

Pra në DT është kërkuar nga OE që të deklaroj se nuk do të ofertoj me çmime nën 50% të tarifave të TOA. Ndërsa tenderuesi i rekomanduar ka deklaruar se çmimet e tij janë në përputhje me TOA (por nuk ka deklaruar se nuk ka ofertuar nën 50% të tarifave të TOA). Me shumë respekt mund të thuhet se në aspektin legjitim/moral tenderuesi i rekomanduar është në rregull për faktin që ai në disa pozicione të paramasës ka ofertuar nën 50% të TOA (shih pretendimin nr. 3) dhe asnjëherë nuk ka deklaruar se nuk do të ndërmerri një veprim të tillë. Sidoqoftë, kërkesa e DT ka qenë pikërisht e kundërta dhe për këto arsye tenderuesi i rekomanduar nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të DT.

Nga sa u tha më sipër, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Nga sa u tha më sipër, kërkojmë nga ZPP që të merr këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe aktiviteti i prok. kthehet në **Rivlerësim**. Nga sa u tha më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesa për rishqyrtim ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **rivlerësim**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*